



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,
Ref:29.06.2017\562-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Shkëlqim Devolli- Devolli Group kundër Kosovës
Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Shkëlqim Devolli ua ka "mbyll gojën" partive me para të pista" të datë 30.05.2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Ankesa pretendon se është e pavërtetë se Devolli Group ka importuar grurë pa standarde. Gjithashtu në artikull thuhet se gruri është importuar madje edhe nga Rusia, por të gjitha këto nuk janë mbështetur me asnjë fakt e as vendim të ndonjë organi shtetëror kompetent lidhur me cilësinë e ushqimit.

Në ankesë thuhet se kjo gazetë nuk ka hulumtuar fare që ta gjejë të vërtetën dhe se ka përzier lajmin dhe opinionin, gjë që nuk lejohet me Kodin e Mediave të Shkruara.

Gjithashtu në ankesë thuhet se gazeta Kosova Sot në asnjë mënyrë nuk ka bërë përpjekje që të kërkojë prononcimin e kësaj kompanie për të dëgjuar edhe pikëpamjet e saj lidhur me çështjet ku apostrofohet në artikull.

KMShK, pasi shqyrtoi ankesën, konstatoi se gazeta Kosova Sot ka marrë opinionet vetëm nga opinionistët e vet të zgjedhur, por nuk ka botuar asnjë fakt nga qëndrimet ose konstatimet e organeve kompetente që kontrollojnë cilësinë e grurit, me çka ka shkelur Kreun II (Raportimi i së vërtetës). Gjithashtu gazeta nuk ka kërkuar prononcimin e palës tjetër, me çka ka shkelur Kreun IV (E drejta për t'u përgjigjur).

Opinionin u nxor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionin.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës